



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni Pranveror**  
**Komisioni për të Drejtat**  
**dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Nr. 28**  
**Prishtinë, më 20. 01. 2010, ora 11:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Kosara Nikolić, Enis Kervan, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha, Xhevdet Neziraj, Hetem Arifi dhe Sadik Idriz

**Munguan:** Bojan Stojanović, Hafize Hajdini dhe Zafir Berisha.

**Të ftuar:** Xhevat Azemi nga Agjencia Kosovare për Prona

**Pjesëmarrës tjerë:** mbikëqyrës nga Zyra e Presidentit, KDI-ja dhe OSBE-ja.

**Nga stafi Mbështetës:** Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli

**Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetare e Komisionit**

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 9.12.2009;
3. Shqyrtimi i Draft-Raportit të punës së Komisionit për vitin 2009;
4. Shqyrtimi dhe indentifikimi i detyrave nga Fushëveprimtaria e Komisionit, të përcaktuara me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave që i përmban Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009 dhe caktimi i afateve për përmbushjen e tyre;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/326/L160 dt. 12.6.2009 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë se

- Zyrtarëve të Lartë Publik, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
8. Shqyrtimi për Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/L-36, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti Industri Energji Transport e Telekomunikacion, me amendamente;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 2447/L-164 dt. 30.06.2009 për Financimin e programeve të veçanta të banimit, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikimi Hapësinor, me amendamente;
11. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
12. Të ndryshme

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

### **2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 9.12.2009**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 09.12.2009, me vërejtjen e Kosara Nikolić në versionin serbisht, e cila tha “ nuk kam thënë “ refundiranje” por “ rimbursia “ dhe në vend të fjalës “ pravo in rem “ duhet të jetë “ prava vlasništva “.

### **3. Shqyrtimi i Draft-Raportit të punës së Komisionit për vitin 2009**

**Kryesuesja**, kërkoj nga anëtarët që të deklarojnë rreth raportit të punës se a kanë vërejtje rreth këtij raporti, sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura. Lidhur me këtë pikë hapi debat.

**Xhevdet Neziraj**, ju referua pikës C të raportit rreth mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, tha se nënkomisioni i paraparë për monitorimin e ligjeve i cili ka vizituar KEK-n dhe Doganat e Kosovës, ku shprehu falënderim për drejtorin e doganave për punën e bërë, mirëpo kemi bërë përpjekje disa herë që ta vizitojmë edhe PTK-në por ajo nuk ka pasur kohë të na pres në takim. Kjo do të ishte mirë të ceket në raport, sepse do të duhej të dimë se cila është struktura e të punësuarve në at ndërmarrje. Në vazhdim tha se meqë Numan Balić ka qenë kryetar i grupit për monitorimin e ligjeve **do të ishte në interes që ta bëjmë një** raport dhe të lexohet para Kuvendit në mënyrë që mos të ndodh që ti monitorojmë ligjet dhe mos të ketë efekt pozitiv.

**Kryesuesja**, tha se unë do ti kërkoja z Numan Balić si kryetar i nënkomisionit për monitorimin dhe zbatimin e ligjit të bëjë raport rreth vizitave në institucionet që kemi bërë që ti pasqyroj gjendjen reale dhe vërejtjen rreth PTK-së i cili nuk ka shprehë gatishmërinë për pritjen e Komisionit.

**Numan Balić**, në fjalën e tij tha se gjatë vizitave që ju kemi bërë këtyre institucioneve ka pasur edhe mungesa nga anëtarët e Komisionit gjë që kanë shkaktuar vështirësi në realizimin e tyre. Në vazhdim tha se edhe Kryetari i Komisionit nuk ka qenë në masë të madhe i angazhuar në monitorimin e ligjit, kurse tani është kryetar Komune.

**Prandaj insistoi që së bashku të punojmë në mënyrë kontinuele** sepse pas vizitës që i kemi bërë doganave gjendja është përmirësuar.

Ne kemi pasur takime me përfaqësuesit e Komunave, me pjesëtarë të Komuniteteve tjera duke cekur se mungon koordinimi në mes të anëtareve të këtij Komisioni. Në vazhdim tha se institucionet e Kosovës, udhëheqja e Kuvendit, Qeverisë nuk dëshirojnë të flasin për moszbatimin e ligjeve, prandaj unë do të përgatis raport, ju mund ti dërgoni sugjerimet tuaja në e-mail adresën time dhe do të ishte mirë që ta mbajmë një mbledhje për këtë raport me të vetmen pik të rendit të ditës, jo me këtë agjendë. Ai tha se me shkresë do ta njoftoi Kuvendin për mos zbatimin e ligjeve ku si shembull mori Pejën, ku është shkelur ligji për Vetëqeverisjen Lokale, po ashtu probleme kemi edhe me ligjin për shtetësinë. Pati vërejtje rreth agjendës e cila është shume e ngjeshur ndërsa materialin e kemi marr me vonesë.

**Kryesuesja**, duke u ndërlidhur me parafolësin tha anëtarët e Komisionit si dhe udhëheqja e Komisionit nuk keni qenë në nivelin e përgjegjësive, duke thënë se gjatë një viti kalendarik kemi realizuar 18 mbledhje, kjo neglizhencë ka qenë përgjegjësi e Kryetarit të Komisionit. Shprehu pakënaqësi edhe me koordinatoret e Komisionit duke thënë se kjo agjendë është tepër e ngjeshur. Prandaj për ti kritikuar institucionet tjera se pari ne duhet të jemi në nivel të përgjegjësive.

**Müfera Şinik**, në fjalën e saj tha se ky është Komision shumë i rëndësishëm dhe ka punuar me përgjegjësi sepse gjatë vitit 2009 ka pasur kuorum gjatë mbajtjes së mbledhjeve. Deri tani ju nuk keni paraqitur mendimet juaja personale, që do të duhej të ishin, jo vetëm mendime, por edhe dokumentet. Si problem përmendi se gjuha turke ka qenë në përdorim zyrtar një kohë, por tani nuk është, ky është problem. Lidhur me mungesën e kryetarit i cili është zgjedh kryetar Komune tha se është dashur të veprohet në pajtim me rregullat e punës për zëvendësimin e tij, sepse kjo bie në përgjegjësin tonë. Shprehu shqetësimin se asnjëherë nuk ishte konsultuar për mbajtjen e mbledhjes edhe pse jam zëvendëskryetare, vetëm një ditë përpara jam njoftuar se sot mbahet kjo mbledhje.

**Enis Kervan**, e falënderoi kryesuesen se ka dhënë kontributin e saj në Komision, propozoi që urgjentisht ti drejtohem kryetarit të Kuvendit që sa më shpejt të zgjidhet çështja e Kryetarit të Komisionit. Kërkoj që mbledhja të organizohet në pajtim me rregulloren e punës, jo një ditë përpara të dërgohen materialet për mbledhje. Lidhur me raportin tha që e pajtohem që të miratohet, me kusht që në pikën C të shënohet që Komisioni në monitorimin e zbatimit të ligjeve nuk ka arritur sukses si dhe strukturat Qeveritare nuk e vlerësojnë si duhet punën e Komisionit për Komunitete dhe Kthim. Rreth zbatimit të ligjeve tha se disa nga ligjet nuk zbatohen, shembull mori Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

**Kosara Nikolić**, pati vërejtje rreth dërgimit me vonës të materialeve, është dashur që sa paku 3 ditë ma herët ka kemi në mënyrë që të përgatitemi për mbledhje, shpresoj që kjo nuk do të përsëritet. Në vazhdim tha se vetëm projektligji për shitjen e banesave ka një vëllim të madh të materialit. Ndërsa lidhur me raportin mbështet z. Numan Balić sepse duket hartuar një raport të gjerë dhe të dalim në Kuvend që të njoftohen deputetet me faktet të cilat i kemi konstatuar ne teren.

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

## **PËRFUNDIM**

**Miratohet Raporti i punës së Komisionit për vitin 2009, me vërejtjet e dhëna që të përfshihen në raport.**

#### **4. Shqyrtimi dhe identifikimi i detyrave nga Fushëveprimtaria e Komisionit, të përcaktuara me Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave që i përmban Raportit i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009 dhe caktimi i afateve për përmbushjen e tyre**

**Kryesuesja** i njoftoi se ka qenë pjesëmarrëse në Konferencën e organizuar nga ambasada Zvicerane në bashkëpunim me zyrën për Komunitete të kryeministrit, lidhur me të arriturat e zyrës së kryeministrit. Në anën tjetër kemi konstatimin e anëtareve të Komisionit që zyra e kryeministrit për Komunitete nuk ka qenë në nivel të përgjegjësive. Ishte konstatim i dal që Komisioni duhet të jetë në nivel të përgjegjësive në mënyrë që të gjitha pikat që i takojnë këtij komisioni të shqyrtohen. Por nëse anëtarët e këtij komisioni konsiderojnë që ka ende objektiva që garantojnë të drejtat e Komuniteteve mund të shkojnë si material shtesë që ti bashkëngjiten planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës. Propozoi që ta formojmë një grup punues që të hartojmë planin e punës brenda këtij muaji, ku si orientim do të ketë planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës.

**Zylfi Merxha**, në diskutimin e ti tha se komisioni evropian i parasheh të drejtat e pakicave kurse në komunat ku jetojmë veçanërisht ne Prizren asnjë Rom nuk punon, ky komunitet nuk ka kurrfarë të drejta. Mori shembull mungesën e shollave për Romet, programet në televizion. Ndërsa sa i përket punës së Komisionit nuk mund të themi që nuk ka punuar, sepse e dimë që kemi qenë të zënë me fushatën parazgjedhore.

**Kryesuesja**, Propozoi që ta formojmë një grup punues ku do të marrin pjesë nga një përfaqësues nga secili komunitet që të hartojmë planin e punës, brenda këtij muaji, ku si orientim do të ketë planin e veprimit të Kuvendit të Kosovës.

**Xhevdet Neziri** në fjalën e tij të serishme ndriti si problem faktin që Qeveria, përfaqësuesit ndërkombëtar dhe institucionet tjera vendore po bien në kundërshtim me vetveten. Është bërë e zakonshme të thuhet “Komuniteti” pse nuk përmendet cili komunitet, me ligj parashihet çartë se cilat komunitete jetojnë në Kosovë. Në vazhdim përmendi edhe çështjen e arsimimit të komuniteteve që është problem i kësaj natyre dhe paqartësitë që po krijohen.

**Sadik Idriz**, lidhur me hartimin e planit të punës që është paraparë për sot si pik e rendit të ditës, ishte i mendimit që të shtyhet për një mbledhje të radhës, sepse nesër do të mbahet mbledhje e kryesisë së Kuvendit ku do të debatohet rreth punës së Komisioneve ku një nder pikat e rendit të ditës do të jetë edhe hartimi i planit të punës së Komisioneve. Duhet shikohet mundësia që në hartimin e këtij plani të marrin pjesë nga një anëtarë nga secili komunitet në mënyrë që ta përfundojmë ka fundi muajit të planë, ose në fillim të muajit tjetër.

**Mursejl Haljilji**, njoftoi se gjuha gorane nuk është standardizuar, për të hartuar tekstet shkollore, siq thuhet në planin e veprimit , do të vijë koha për tu bërë kjo.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni njëzëri nxori ketë:

#### **PËRFUNDIM**

*Komisioni vendosi që kjo pik të shqyrtohet në një takim të radhës.*

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesja**, tha se takimin që kemi mbajtur me Komisioni për Bujqësi e kemi marr me përgjegjësi që çështja e këtij projektligji ta përfundojmë brenda këtij muaji. Për këtë kemi ftuar edhe z. Xhevat Azemi nga Agjencia Kosovare për Prona, i cili ka sjell propozimamandamentet që garantojnë të drejtat e të gjithë qytetareve.

**Kosara Nikolić**, diskutoi se në takimet e më hershme na është thënë se kemi një projektligj i nuk është i mirë theksoj se këtij projektligji i mungojnë normat juridike dhe standardizimi ligjor dhe gjuhësor. Kemi nevojë për ekspert për të na ndihmuar për në ndryshimi e domosdoshëm të tij. Pastaj do të procedohet për miratim në Kuvend. Interesi i përbashkët është që të bëjmë ligjin e mirë.

**Numan Balić**, në fjalën e tij tha se do të duhej të kërkojmë që të kemi ekspert që do të na ndihmonin ta shqyrtojmë këtë projektligj, na nevojitet asistencë e kësaj natyre në mënyrë që të përshpejtojmë procedimin e këtij projektligji.

**Xhevat Azemi**, nga Agjencia Kosovare për Prona, në fjalën e tij tha se këtu nuk jam në cilësi të përfaqësuesit të asaj agjencie, mirëpo jam këtu për faktin që kam marrë pjesë në shumë takime, ky projektligj ka të meta mirëpo nëse nuk ndërmerren veprime konkrete këto çështje nuk do të zgjidhen asnjëherë. Në vazhdim dha arsytetime rreth këtij projektligji duke thënë se ekziston gatishmëri nga subjektet e caktuara që ky projektligj të përmirësohet dhe të procedohet sa më shpejt.

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **PËRFUNDIM**

*Komisioni vendosi që këtë pik ta shqyrtoi në një takim të radhës ku do të ftohen përfaqësuesit e ICO, OSBE, ambasadës amerikane, përfaqësuesi i Komisionit evropian si dhe të gjithë ata që mund të kontribuojnë kësaj çështje.*

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/326/L160 dt. 12.6.2009 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente**

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik, me raportin e komisionit**

## **funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **8. Shqyrtimi për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/L-36, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Duhanin nr. 02/L-36 dhe amendamentet e komisionit funksional ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **9. Shqyrtimi i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi Tregti Industri Energji Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për turizëm dhe shërbime turistike dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 2447/L-164 dt. 30.06.2009 për Financimin e programeve të veçanta të banimit, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikimi Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Financimin e programeve të veçanta të banimit , dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **11. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

### **REKOMANDIM**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit , dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

### **12. Të ndryshme**

**Kryesuesja** i njoftoi anëtarët rreth vizitës që do të bëjë komisioni në Zvicër, duke ju ofruar sqarime rreth plotësimit të dokumenteve, agjendën si dhe kohën e udhëtimit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

**Përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Zëvendëskryetarja e parë Komisionit  
Sanije Aliaj**

---